



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8.2.2023

Nr: 45

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE TË BASHKISË DURRËS, PËR
PERIUDHËN 20 JANAR – 23 JANAR 2023**

Sot, më datë 8.2.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Durrës

OBJEKTI: Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Durrës për periudhën 20 janar deri më 23 janar 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 21, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës së monitorimit 20 janar deri më 23 janar 2023, Bashkia Durrës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së, 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Mbjellje pemësh dhe shtim i koshave në qytet”, raportuar në datë 20.1.2023 dhe me datë zhvillimi të aktivitetit 20.1.2023.
2. Aktivitet “vendosje e ndriçimit të ri në rrugën Haziz Shkupi”, raportuar në datë 21.1.2023 dhe me datë zhvillimi 21.1.2023.

Data: 8.2.2023 Nr: 45
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Durrës, për periudhën 20 janar – 23 janar 2023”

Me shkresën nr. 461 prot., në datë 28.1.2023, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Durrës , informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t'i paraqesë ato në seancën publike të datës 8.2.2023, ora 11:00.

Në seancë publike ishte e pranishme përfaqësuesja e bashkia Durrës zj. Almiva Llaçi, e cila parashtrori si argumente se: *“Për raportim tej afatit ligjor ka pasur probleme me aksesimin e ndërfaqes. Për sa i përket natyrës së aktiviteteve, argumenton se njëra veprimtari është mbjellja e pemëve/shtimi i koshave në qytet dhe tjetra është vendosja e ndriçimit të ri në një rrugë të qytetit të Durrësit. Në postimin e bërë ka vetëm një panoramë të qytetit të Durrësit dhe nuk ka prononcim të kryetarit apo premtim elektoral. Postimi është shfaqur vetëm në faqen personale të titullarit. Nuk ka pamje të Kryetarit të Bashkisë dhe pjesëmarrje të shtypit apo qytetarëve.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura nga përfaqësuesja e Bashkisë Durrës dhe pasi verifikoi rrethanat e pretenduara prej saj, krijoi bindjen se aktivitetet janë raportuar jashtë afatit ligjor pa shkak të justifikuar.

Nisur nga tematika e veprimtarive të raportuara dhe përshkrimit të tyre, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Durrës ka shkelur detyrimin ligjor duke mosraportuar brenda afatit të përcaktuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 21, pika 1 shkronja “dh”, dhe nenin 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

VENDOS:

1. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për zj. Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës, me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI